

OBJEKTI: SKULPTURA NE QYTET

TERMAT E REFERENCËS SË KONKURSIT

1. Hyrja

Bashkia Durres fton artistë kombetare që të paraqesin propozime për një projekt që do të zhvillohet ne hyrje te shetitores Taulantia.

Projekti i vitit 2018 është nje seri e projekteve te ndryshme te hartuara ne Bashkine Durres qe prej vitit 2013, ku ne qytet u vendosen skulptura te rendesishme qe e lidhnin qytetin e Durresit me artin e muzikes si John Lenon, Tina Turner dhe Mick Jagger, gjithashtu vepra te ndryshme jane vendosur ne qytet pergjate shetitores turistike, nga artiste vendas, permendim ketu Nudon e sheshin e Sfiknksit, 2 Luftetaret ne Taulantia, apo edhe skulpturen e Drites ne Sheshin Liria. Keto skulptura jane bere pjese e Bashkise Durres nepermjet procedurave te financimit te institucionit si dhe dhurimit nga institucione private.

Duke iu refereuar kesaj qasjeje te rendesishme me veprat moderne ne qytet, ky konkurs eshte pjese e ketij vizioni per ta bere qytetin e Durresit nje qytet mesdhetar bashkekohor ku qytetaret e tij dhe turistet qe e vizitojne te percceptojne kete unifikim dhe lidhje pertej Ballkanit.

1.1 Baza ligjore

Hartimi i ketij dokumenti bazohet ne VKM nr. 510, datë 18.7.2012 “Për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e veprave monumentale të artit pamor”;
Udhëzimin nr. 1, datë 8.8.2012 mbi procedurat që ndiqen për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e veprave monumentale të artit pamor, kriteret e vlerësimit dhe dokumentacioni ligjor.

2. Qëllimi

Synimi i përgjithshëm i projektit eshte:

- Të prezantojë artin përgjatë një zone shume te rendesishme historike- turistike me fluks te larte levizjeje

- Të zhvillojë artin që është frymëzuar nga vendi i tij

3. Objektivi

Ajo që kerkohet të arrihet nga ky konkurs është një skulpturë e pozicionuar në një nga qendrat e qytetit. Ky konkurs zhvillohet mbi temën e mitologjisë, mbi të cilën do të bëhen propozimet artistike.

Vepra duhet të evokojë historinë e qytetit të Durrësit dhe, meqë do të vendoset në një vend publik, kështu që nderthuret e reja me trashëgiminë historike, kërkon përkujdesje për të përket termave të referencës që domosdoshmërisht duhet të marrin në konsideratë rreptesisht kufijtë shkencorë të shtresave mitologjike dhe historike.

Nisur nga përvoja botërore por dhe e jona (figurat e mirëfillta mitologjike janë pjesë e Muzeve Arkeologjike) do të që një zgjidhje optimale dhe e pranueshme që këto krijime të vijnë si replika të tyre dhe jo si figura të reja: për këtë orientojmë krijimin e figurave evazive, me dy ose disa lexime, me zanafillën nga periudha helene, romake apo ilire.

Më specifikisht, meqë historia gati 3000 vjeçare e Epidamnit, vjen me një gjurmë gjeografike e kufizuar nga deti, kjo veprë duhet të materializojë disa elemente kulturore, gjeografike dhe historike shumë të rëndësishme në një objekt artistik të vetëm:

Mitologjia ilire - ku Rodon ishte perendia e detit,

Historinë – rëndësinë dhe rolin që ka patur qyteti ndër mijëvjeçare

Gjeografinë - terrenin kodrinor që ka qyteti në pjesën perëndimore të tij deri në Kepin e Rodonit, origjinin e këtij emri

Këto elemente të rëndësishme duhet të përktëhen dhe të vendosen në një raport harmonik me hapësirën fizike ekzistuese dhe me kujtesën historike të cdokujt për këtë qytet.

Elementet kompozicionale të veprës duhet t'i reflektojnë artedashësit, qytetarit, praninë e dritës, detit, hapësirës.

3.1 Konkurrenteve u kerkohet të zhvillojnë si më poshtë:

- Të studiojnë kontekstin historik të qytetit
- Të studiojnë zonën e konkursit dhe zonat përreth lidhur me këtë pikë
- Të propozojnë vepra të cilat të perceptohet e plotë në të gjitha drejtimet
- Të kryejnë një vlerësim të përafërt të kostos
- Të propozojnë një plan veprimi

- Të propozojë komponentë që e bejnë propozimin të zbatueshëm.

4. Vendndodhja

Pozicioni i propozuar i vendosjes së vepres është në rrethrotullimin që gjendet midis sheshit Veliera dhe hyrjes për në shetitoren Taulantia

Planimetrite dhe fotot bashkëngjitur në shtojcë 1.

5. Materialet e mundshme dhe ndërtimi

1. Materialet ndërtimore duhet të jenë të qëndrueshme për t'i bërë ballë motit dhe mundësive të vandalizëm dhe vjedhje.
2. Materialet e vepres duhet të jenë të natyrës moderne duke qenë pranë një sheshi me finitura moderne. Propozimet do të pranohen në metal (corten, inoks, etj) si dhe vepra mund të integrohet me materialin e ujit në formën e pasqyrave ujore apo shatërvanit në përzgjedhje të artistit.
3. Propozimet duhet të mbajnë në konsideratë veçoritë e motit siç është qyteti i Durrësit i diellezuar në pjesën më të madhe të vitit
4. Lartësia e vepres të konceptohet rreth 8 – 10m, duke ruajtur kështu një raport me sipërfaqjen e rreth rrotullimit
5. Vepra nuk duhet të paraqesë një rrezik.
6. Materialet dhe metodat e kapjes apo të vendosjes së vepres duhet të merren parasysh në aspektin e parimeve të qëndrueshmërisë
7. Projektet që kanë potencial të bien duhet të rishikohen nga një inxhinier strukturor dhe duhet të dizajnohet me një bazë të përshtatshme.

6. Buxheti

Buxheti në dispozicion për këtë veper është miratuar në PBA me VKB nr 469 dt 23.12.2017 dhe është maksimalisht 30.000.000 Leke me tvsh me shpërndarje për 1 vit.

Ky buxhet mund të financojë një seri pjesesh, ose një skulpturë të vetme, brenda shtit të dhënë për këtë veper. Gjithashtu, artistët mund të propozojnë një projekt që nuk kërkon shpërndarje të plotë të buxhetit total.

Buxheti është për të financuar idene e artistit fitues, shpenzimet e mundshme të konsulentëve në rast të vecanta të procedurës, materialet, fabrikimet, realizimin e vepres dhe kostot e instalimit, përfshirë dhe vendosjen e themeleve në rastet që e propozon projekti.

Buxheti do të ekzekutohet sipas vleresimit të projektit fitues, me kusht nëse projekti e kërkon teknikisht një financim të tillë, ose ndryshe me vendosjen e vepres në objekt, bazuar në fazat e përfundimit. Duhet përmendur se në situatat ku artisti është duke punuar në publik, artisti duhet të ketë sigurim të përgjegjësisë.

7. Kalendar

Thirrja për artistët e shpallur deri më 19 Shtator 2018

Propozimet e duhura dorëzohen më 19 Shtator 2018 ora 14.00 fizikisht në adresën:

Bashkia Durrës

Sheshi Liria, L.1, Durrës

Procesi i jurisë: 19 – 26 Shtator

Vlerësimi i fituesit 26 – 1 Tetor

Afati i lidhjes së kontratës: 15 ditë pas vleresimit të jurisë

Zhvillimi i konceptit dhe vendosja e vepres në zonën e caktuar, janë afate që caktohen në kontratë

8. Përshtatshmëria

Ky konkurs është i hapur për artistët profesioniste të zhanrit të skulpturës, individë ose ekipe.

Propozimi i konkurentit/ konkurrentëve duhet të përfshijë si më poshtë:

1. Deri në një faqe tekst që përshkruan konceptin e artistit dhe se si do të mund të implementohet projekti (faqja e madhësisë së letrës standarde).
2. Vizatime dhe çfarëdo materiali tjetër grafik që mund të ndihmojnë ilustrimin e propozimit të artistit
3. Madhësia e vizatimit duhet të kufizohet maksimalisht 20cm * 50 cm.

4. Ngjyra ose grafika bardh e zi do të ndihmojnë. Nëse materialet ilustruese janë jo të plota, propozimi nuk do të qëndrojë;
5. Dorezimi i modeleve ose i videove prezantuese të tyre

8.1 Dokumentet që duhen dorezuar

Artikujt 1 & 5 duhet të jenë anonime (emrat/logot të mbuluara).

Artikujt 6 - 10 do të pakëtohen në një zarf për jurinë për t'i shqyrtuar veçmas.

6. Kopje diplome e noterizuar.
7. Një CV që tregon për backgroundin e artistit
8. Fotot ose imazhet dixhitale që ilustrjnë një sërë projektesh të përfunduara të artit. Numri i imazheve duhet të kufizohet në dhjetë.
9. Një buxhet i vlerësuar i ideve - prodhimit dhe afati për krijimin, furnizimin dhe instalimin.
10. Plotesimi I shtojces 6 DST

Një kopje e propozimit duhet të dorëzohet me datë 19 shtator 2018, ora 14.00, në:

Bashkia Durrës

Sheshi Liria, L.1, Durrës

- Nuk do të ketë kompensim për përgatitjen e propozimeve;
- Konkursi do të zhvillohet me pjesëmarrjen minimumi 3 (tre) artisteve ose perfaqesi artistesh; pjesëmarrja e me pak konkurrenteve e bën procesin të pavlefshëm.
- Bashkia nuk është e detyruar të shpallë fitues nëse nuk ka propozime të përshtatshme

Afati i fundit për dorëzimin është 19 Shtator 2018, ora 14.00.

Prezantimi i projekt ideve do të shqyrtohet nga një grup i jurise që kanë background në pikturë dhe skulpturë

9. Kriteret e Vlerësimit

Juria do të vlerësojë konkurrimin bazuar në kriteret e mëposhtme:

1. Qartësia dhe plotësimi i dokumenteve të kërkuara
2. Përbërja profesionale e skuadrës

3. Eksperiencat e ngjashme të artistit ose grupit të artisteve
4. Qartësia dhe efikasiteti i metodologjisë së propozuar
5. Lidhja e vizionit të prezantuar me zgjidhjen e përcaktuara në konkurs
6. Krijimtaria
7. Faktori i lartë i zbatueshmërisë
8. Lidhje dhe impakti i propozimit me kontekstin
9. Raporti kosto-impakt (kosto e ulët, impakt i madh)
10. Detajimet jepen në shtojcën 6 të DST

9.1 Sistemi i pikezimit i gjykuar sipas grupit ToR:

1 -100 pike sipas paragrafit 9.

Nga 1 – 4	30 pike
Nga 5 – 6	40 pike
Nga 7 – 10	20 pike
Afati i zbatimit	10 pike

Ne vartesi të pjesëmarrjes në këto gara, Bashkia Durrës, me përfundimin e saj do të bëjë një ekspozitë të punëve pjesëmarrëse në këtë konkurs.

Grupi i Termave të References

Shtojca 1

Foto nga terreni ku do te pozicionohet vepra







